



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 112/13
Prishtinë, më 26.06.2013, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziri, Sevdije Lama, Hykmete Bajrami dhe Duda Balje.

Mungoi: Naser Osmani.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Imba Rudaku, Albulenë Gashi, Arbëreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj- Ministër i Financave, Qerkin Berisha, Agim Krasniqi, Leonita Shabani nga Ministria e Financave, Valon Maloku- Koha Ditore, Pranvera Musa- Kosova Sot, Arsim Rashiti- Kosova Live, Fisnik Morina- Universiteti publik-Haxhi Zeka, Teki Shala-Ekspert i jashtëm.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 05.06.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;
4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116;
5. Shqyrtimi i raportit më Amendamente për Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale;
6. Shqyrtimi i raportit plotësues për projektligjin nr. 04/L-163, për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor;
7. Shqyrtimi i raportit plotësues për projektligjin nr. 04/L-185, për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike, të prodhuara në Kosovë;
8. Shqyrtimi i Raporti financiar vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012;

9. Shqyrtimi Raportit financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja kërkoj nga anëtarët të deklarohen për miratimin e rendit të ditës.

Sali Asllanaj theksoi se Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2013, e ka marrë sot, dhe nuk ka mundur të përgaditem për këtë takim. Kam qenë të hënën në Kuvend dhe paradite nuk kam pasur materialin në kuti. Propozoj që të shtyhet kjo pikë për një mbledhje tjetër.

Latif Gashi konsideroj se materiali është me vonesë dhe meqë është shqyrtimi në parim nuk nevojitet shumë kohë. Jam pro shqyrtimit të këtij Projektligji me qëllim që t'i rekomandojmë seancës ta kaloj, pastaj përmes shqyrtimit në komision dhe grupe punuese do të diskutohet më gjatë.

Albana Fetoshi nuk arrijë të kuptoj shpejtësinë për t'u shqyrtuar ky Projektligj e konsideroj të paarsyeshme të hyj tani në rend të ditës, poashtu të na tregoj Ministri pse duhet patjetër të hyj për shqyrtim në seancën e radhës, pse të mos shtyhet edhe për një javë. Nëse është për shkak të fondit - negociatave me Serbinë është absurde për shkak të shpejtësisë së Serbisë të analizohet ligji për një ditë.

Kryetarja theksoj se asnjëherë nuk e kemi bërë në kohë më të gjatë shqyrtimin e ligjit, nuk e kuptoj administratën pse materiali nuk është shpërndarë me kohë por Projektligji për Buxhetin ka ardhur para një jave.

Besim Beqaj sqaroj se me datën 17 qershor është aprovuar në Qeveri rishikimi, dhe në po të njëjtën ditë është dërguar në Kuvend para mbledhjes së Kryesisë, nuk ka arsye se po bëhet me shpejtësi sepse buxheti është një dokument që paraqet një konsolidim të përgjithshëm të politikës shtetërore dhe këto janë afatet të caktuara kohore.

Kryetarja poashtu sqaroj se në Komision jemi me procedura ashtu siç i kemi shqyrtuar të gjitha projektligjet, pas 10 ditë Projektligji kalon në Seancë dhe duhet ta kemi një material të dërguar.

Albana Fetoshi konsideroj se nëse nuk ka shpejtësi atëherë është vonesë, pasi që vetëm një ditë kemi pas mundësi me shiku projektligjin dhe çështja tjetër është se nuk është përfshirë buxheti për vitin 2013, pastaj mungon buxheti i rishikuar. Për ti bërë këto krahasime nevojitet një javë.

Hykmete Bajrami vlerësoj se Qeveria ka respektuar të gjitha afatet ligjore, por nuk ka mjaftuar koha sepse është marrë me vonesë, poashtu në të gjitha tabelat e tjera përveç në tabelën 1 nuk është buxheti sa ka qenë për secilin projekt. Nëse duhet të trajtohet buxheti duhet të mbahen disa mbledhje.

Latif Gashi kërkoj mirëkuptim prej të gjithë deputetëve sepse deri më tani jemi munduar të kemi një klimë profesionale duke shikuar interesin e përgjithshëm të qytetarëve duke tejkaluar edhe interesat politike. Është fakt që materiali është ardhë me vonesë por si rezultat i administratës, meqë kemi shqyrtimin në parim dhe rasti të punojmë në grupe punuese, mendoj se duhet të jetë pikë e rendit të ditës pasi që është i pranishëm edhe Ministri.

Xhevdet Neziraj vlerësoj se materiali nuk është analizuar pasi që nuk e kemi marrë me kohë dhe

propozimet për shtyerje në një mbledhje tjetër janë të arsyeshme.

Kryetarja kërkoj mirëkuptim që të shqyrtohet sot Projektligji për Buxhetin dhe me ndihmën e Ministrit dhe Drejtorit të jipen sqarime se ku janë bërë ndryshime dhe plotësime.

Sali Asllanaj nuk mendoj se është çështje e diskutimeve por një e drejtë elementare e deputetëve për debat. Edhe po të doja të jipja një kontribut optimal nuk kam mundësi, se nuk kam pasur kohë të shikojë draftin.

Kryetarja konstatoj se miratohet rendi i ditës me gjashtë vota Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sevdije Lama, Duda Balje), katër vota Kundër (Albana Fetoshi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj) dh asnjë Abstenim.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 05.06.2013

Albana Fetoshi kërkoj përmirësim lidhur me diskutimin e saj, përkatësisht të korrigjohet një gabim teknik dhe fjalia dhe të thuhet në një pjesë të caktuar të territorit, si dhe diskutimi lidhur me mallrat e liruar nga tatimi doganor ka qenë më i gjatë se sa është përfshirë.

Kryetarja konstatoi se miratohet procesverbali me vërejtjet e deputetes Albana Fetoshit, të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbal.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryetarja sqaroj se në Projektligj kemi disa plotësim-ndryshime tek pjesa tekstuale dhe tabelare. Ndryshimi i parë - rregullon krijimin e fondit zhvillimor të mirëbesimit që do të krijohet nga përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian për Komunat Veriore të Kosovës. Ndryshimi i dytë rregullohet mënyra e ndarjes së shpenzimit të Fondit për shpenzime kontingjente nëpër komuna të reja. Ndryshimi i tretë rregullohet mënyra e ndarjes dhe shpenzimit të kontingjencës për financimin e ish të dënuarve politik dhe mënyra sesi ka ardhur ky ndryshim në Projektligj nga Qeveria nuk është në formën e duhur ashtu siç është kërkuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Nuk ka shumë ndryshime aq të mëdha nga varianti bazë, nëse shohim brendësinë e buxhetit vërejmë se janë disa ndryshime të cilat janë kryesisht rialokime brenda organizatës buxhetore, të cilat janë bërë në drejtim të rritjes së eficiencës dhe efikasitetit në realizimin e buxhetit për vitin 2013. Ka mos ndryshim të kufijve në *Paga dhe Mëditje* dhe në punësim, kryesisht është bërë rregullim i financimit brenda ndarjeve buxhetore për të gjitha obligimet që i ka Qeveria në raport me financimet nga kreditë dhe bashkëfinancimet.

Besim Beqaj konstatoj se shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Buxhetin është i harmonizuar me bazën ligjore dhe deri në një masë edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar sipas të cilëve duhet të kemi të vendosur rregullën fiskale dhe disa limite të natyrës së ruajtjes së stabilitetit makrofiskal. Në vizitën e rregullt për rishikimin e Marrëveshjes “Stand By” jemi të harmonizuar në parim me FMN-në për rishikimin buxhetor të vitit 2013 dhe me parimet bazë për buxhetin e vitit 2014. Neni 3 pika 4 ku flet për krijimin e fondit për shpagimin e të burgosurve politik kemi harmonizuar qëndrimin me FMN-në. Në rishikimin e buxhetit të hyjë shuma prej 2 mil € për kompensimin e të burgosurve politik i cili dallim në raport me atë çka është dërguar ka të bëjë se duhet të bëhet vlerësimi fiskal para alokimit të mjeteve. Nuk e kemi të ditur numrin e të burgosurve politik kemi lënë një fond kontingjencë, i cili do të shfrytëzohet atëherë kur ti kemi listat e plota. Projekt buxheti trajton edhe fondin zhvillimor të mirëbesimit pra, mundëson themelimin e fondit. Rialokimet e brendshme janë

lejuar brenda organizatave buxhetore. Poashtu kemi disa alokime të reja të limituara.

Albana Fetoshi theksoj se tek fondi zhvillimor i mirëbesimit është absurde të mendohet se po hapet një fond zhvillimor ndërkohë që Qeveria nuk bënë asgjë për zhvillimin ekonomik në gjithë territorin. Sa i përket çështjes se fondet shkojnë në thesar e pastaj në fondin zhvillimor nuk do të ketë ndarje, me këtë nën shkelet ligji për menaxhimin e financave publike sepse këto fonde qysh në fillim janë të destinuara se ku do të shkojnë. Pyetja tjetër është që të gjitha këto mallra që do të futen nga komunat e veriut, të cilat janë të destinuara për konsum të brendshëm, në këto komuna përmes pikave doganore në Kosovë, do të duhej të dërgojmë duke i identifikuar edhe duke i regjistruar veçanarisht në anën zhvillimore. Si është e mundur të dijmë që ato mallra janë antikonsum dhe do të ndalën në Veri dhe nëse e dijmë se do të ndalen atje, kjo nuk ka logjikë. Madje kjo Qeveri na ka lodhur duke folur për tregtinë, ndërsa nga ajo që është propozuar po cakton se ku ka më i dërgu mallrat që është kundër kësaj logjike dhe e papranueshme. Në parim ne si Grup parlamentar i Vetëvendosjes jemi kundër nenit 2, sepse mendojmë se ky nën është arritë me negociata që janë zhvilluar në Bruksel, pasi që qytetarët e Kosovës mendojnë se paraja publike mos të keqpërdoret. Pyetja e fundit ka të bëjë me atë që është paraparë që përfaqësuesi special i BE-së, do ta krijoj fondin e mirëbesimit, si mundet Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian të krijoj fond, me parat publike të Kosovës?

Latif Gashi sa i përket nenit 2 që e ngriti e nderuara deputete unë i them asaj se ky nën është fitore e madhe e Shtetit të Kosovës në raport me Qeverinë Serbe që ka insistuar jo vetëm fond, por krijimin e një autonomie apo një Republike brenda në Veri. Neni 2 paragrafi 3 ndër të tjera thotë: të hyrat duhet të dërgohen në fondin e Kosovës, kjo nënkupton se kudo që të vendosen mejtet, ato janë mjete të Republikës së Kosovës dhe do të kalojnë përmes thesarit sikurse kalojnë edhe mjetet tjera për organizatat tjera buxhetore.

Hykmete Bajrami theksoj se e ka shumë të vështirë me besu se neni 2 i pëlqen edhe Latifit, por edhe deputetëve tjerë, me përjashtim të minoritetit serb, por rrethanat në të cilat gjendemi janë diçka tjetër, por duhet bëhet e qartë se është problem me i thënë të bardhës e zezë apo anasjelltas. Sa i përket nenit 2 nuk kemi një afat të caktuar kohor dhe mbetet të shihet se deri kur do të ekzistoj ky fond zhvillimor. Pavarësisht se a kalojnë nëpër thesar ato në të hyrat e dedikuara, po bëhet një lloj diskriminim me komuat e regjionet tjera. Por është shumë e dyshimt situata se si do të kontrollohet dhe kjo mund të mundësojë që edhe komunat të tjera me shumicë serbe, me i dërgu të hyrat e veta në fondin e caktuar duke regjistruar biznesin në Veri dhe sipas bazës ligjore nuk mundemi ti ndalojmë. Sa i përket këtij fondi kontingjent për kompensimin e të burgosurve politik, pikërisht prej vizitave të FMN- së, ka pas kritika se është një fond shumë i madhë, janë regjistruar deri në 6.000 të burgosur dhe kostoja e atij fondi është 50 milion euro. Pyetja ime është a është i paraparë fondi në zbatimin e ligjit të veteranëve të luftës dhe sa është kostoja e tij?

Shihet se shërbimet rrjedhëse janë rritur për 5 milion euro, tek Pagat e Mëditjet janë rritur për 1 milion, Mallrat e Shërbimet poashtu janë rritur për 1 milion, Tansferet sociale 3 milion, Subvencionet për ndërmarrjet publike janë zbritur për 1 milion, si dhe Shpenzimet Kapitale janë zbritur për 4 milion €. Poashtu edhe bilanci bankar është rritur për 1 milion €. Do të doja nga drejtori i buxhetit të na jap disa specifika ku ka pas ndryshime më të mëdha në projektet kapitale, pasi që për aq sa kam pasur kohë të analizoj në tabelë duket që nuk janë bërë vetëm brenda kategorive, por kanë kaluar edhe në kategori tjera dhe shpenzimet rrjedhëse janë rritur për 5 milion €.

Latif Gashi ajo çfarë theksoj zj.Hykmete lidhur me nenin 2 dhe përmendjen e emrit tim, është e drejtë e asaj të shpreh mendimin e lirë. Për që dallojmë unë dhe ajo, nuk ka dyshim, në veprime e në mendim dhe

jo rastësisht kemi pas fatin me ju pri shumë proceseve që e kanë ndërruar historinë nga robëria në liri edhe sot proceset historike të vendit tim, unë i shoh ndryshe në raport me ju dhe me Albanën. Pjesa e Veriut është pjesë e sovranitetit të Republikës së Kosovës, fal ndihmës së faktorëve ndërkombëtar dhe sot për herë të parë në historinë e kombit tonë realizojmë një fitore të madhe edhe vota ime është pro dhe e shoh një sukses të madh të kësaj Qeverie .

Kryetarja sqaroi se sa i përket çështjes së fuqisë së ligjit që e diskutoj Albana sipas rregullave ligjore që na kanë shpjeguar më shumë juristët që merren me këtë problematik, marrëveshjet ndërkombëtare kanë fuqin mbi ligjet. Ndërsa sa i përket afatit jemi kureshtar të dijmë edhe nga Ministria këtu ne e miratojmë këtë ligj për gjashtë muaj, dhe çështja e afatit kohor të përmendur me nenin 2 duhet trajtuar kur të diskutohet ligji i buxhetit vjetor.

Besim Beqaj theksoj se fondi është ndarje buxhetore me ligj të buxhetit dhe është në harmoni të plotë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe janë mjetet të destinuara dhe nuk është fond i përhershëm. Fondi ka afatin me ligjin e buxhetit dhe nuk lidhet me asnjë ligj tjetër. Është me rëndësi se mjetet që hyjnë në buxhetin e Kosovës përmes thesarit, pastaj do të ndahen si mjete të destinuara për pjesën e komunave të cilat janë të reflektuara në nenin 2. Sa i përket kontrollit, është shumë lehtë të kontrollohen sepse flasim për përfundimin e ciklit të lëvizjes së mallrave. Ndërmarrjet mund të regjistrohen në Veri, por jo edhe ndërmarrjet që marrin me destinim atje, nuk mund të transferon shitje dikun tjetër sepse është Administrata Tatimore e cila e kontrollon procesin. Ndërsa mallrat që doganohen atje për destinim tjetërkund shkojnë në terminalin doganor i cili është terminal doganor i rregullt dhe kjo çështje është menduar mirë. Sa i përket fondit kontigjent ne kemi ndarë shumën prej 2 milion €, por ende nuk e kemi listën përfundimtare dhe prandaj nuk kemi predikuar shumat. Në momentin që do të bëhen listat dhe vlerësimi financiar, do të ndahen mjetet buxhetore. Sa i përket kategorive të dala nga lufta, procesi i regjistrimit dhe krijimit të listave parashihet të kryhet deri në fund të këtij viti, kjo duhet të reflektohet në buxhetin e viti 2014, ndërsa pjesa tjetër, sikur të burgosurit politik, presim të përfundohen listat dhe do të alokohen mjetet konform ligjit të miratuar. Ky ligj vetëm sa e forcon funksionimin e sistemit dhe besoj që pas shumë vitesh që kemi pas të pa kontrolluar pjesën e veriut, përmes këtij fondi, qeveria do të ketë siguri dhe sitem më të plotë të informatave.

Albana Fetoshi pyet Ministrin se me çfarë baze ligjore mbështetet e drejta e përfaqësuesit special të Bashkimit Evropian që të krijoj fondin zhvillimor?

Besim Beqaj në përgjigjen e parafolëse theksoi se ligji i mundëson themelimin e fondit dhe kjo po bëhet përmes këtij ligji.

Kryetarja konstatoi se duhet të anashkalohen aversionet politike por secili ka të drejtë me i shpreh rezervat e veta, poashtu ka të drejtë me e mbrojt kush e sheh të arsyeshme me mbrojt këtë, mirëpo jemi në një proces që duhet t' i dërgojmë gjërat përpara.

Agim Krasniqi njoftoi se rishikimi i buxhetit i përfshin të gjitha realokimet transferet që ka ndodh prej momentit të aprovimit e deri në momentin që ka ardhur në Kuvend. Në rishikim të buxhetit kemi ndarje të reja rreth 7.8 milion €, ndarje të reja duke pas parasysh shkurtimet në buxhet përkatësisht shkurtimet në pjesën e projekteve kapitale të cilat nuk kanë pasur as zotim e as shpenzim që do të thotë se kanë qenë mjete të lira, kanë shkuar mjete në pozicionet të cilat kanë pasur obligime siç është rasti me ish të burgosur të cilëve i janë ndarë 2 milion €. Në kategorinë e pagave nëse shikojmë tabelat në fillim prej 600 milion €, ka qenë një problem teknik i numrave që janë rregulluar. Këto mjete janë shpenzuar për universitete të reja, por edhe dy vendime më herët që kanë qenë të Qeverisë, njëra që ka të bëjë me bashkimin e gjyqtarëve e prokurorëve dhe tjetra një shtesë për Komunën Veriore. Pjesa tjetër është

planifikime buxhetore të Ministrive, Komunave për projekte të caktuara. Vlen të përmendet një rast tek AKP -ja i kanë tepruar një në dhjetë projekte të cilat kanë qenë projekte të vogla, duke i vendosur në një projekt të ri apo në një ekzistues, e gjithë kjo për të rritur efikasitetin dhe efqencen e buxhetit. Edhe tek të burgosurit është përfitim i njehershëm-dinamika se si të shpërndahen këto fonde të planifikuara, ai i cili përfiton një benificion do të jetë i përhershëm.

Pas diskutimeve, Komisioni me shtatë vota Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziri, Sevdije Lama dhe Duda Balje), dy Kundër (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi) dhe asnjë Abstenim, nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligji për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116

Kryetarja njoftoi se grupi punues ka përfunduar punën dhe janë propozuar disa ndryshime. Në ndërkohë kanë ardhur edhe disa sugjerime nga Komisioni Evropian, për të cilat është dashur të konsultohemi dhe me Ministrin e Financave, sepse ka qenë një ndryshim në departamentin e thesarit, ka qenë një njësi për menagjim dhe kontroll dhe komisioni evropian ka sugjeruar të kaloj si njësi e veçant që merret me auditimin.

Më pas filloi procedura e amendamentimit dhe amendamenti 1,2,3 dhe 4 u miratuan njëzëri.

Kryetarja sa i përket amendamentit 5 është lënë të vendoset në komision, pasi që ka të bëjë me themelimin e dy departamenteve të buxhetit në kuadër të Ministrisë së Financave. Në fakt Komisioni me rastin e monitorimit të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ka rekomanduar që të mbetet si në ligj, një departament i përgjithshëm i buxhetit dhe dy njësi, njëra për buxhet qendror dhe tjetra për buxhet komunal. Unë mbetem prapa këtij rekomandimi të Komisionit, të miratuar në Kuvend.

Albana Fetoshi theksoi se është më mirë të mbetet rekomandimi i komisionit, që të jetë një departament i përgjithshëm me dy njësi, sepse do të jetë problem të harmonizohen po të jenë dy departamente.

Hykmete Bajrami nëse ne duam të bëjmë ndryshime në ligj për t'i futur njerëzit nën kontroll mua personalisht nuk ma merr mendja që ajo do të jetë funksional. Më qenë një drejtor i buxhetit i nivelit qendror dhe i nivelit lokal nuk e di sa do të funksionojë, por do të ishte të dëgjojmë mendimin e drejtorit të buxhetit.

Besim Beqaj ashtu siç po reagon kryetarja dhe një numër i deputetëve ashtu kam reaguar edhe unë si ministër, duke konsideruar që do duhet të ishte brenda një kornize dy departamente po që në aspektin e funksionalitetit krijon problem pak më shumë, sepse komunikim është më i lehtë, i një drejtorit të departamentit i cili komunikon me komuna veç e veç dhe njësit buxhetor që vijnë nga nivele qendrore dhe këta dy e konsolidojnë buxhetin.

Kryetarja nuk kemi nevojë me i kriju dy departamente, ma mirë është mu respektu mendimi i komisionit dhe rekomandimi i komisionit që e ka dhënë kur e ka monitoruar ligjin që të jetë një departament dhe në kuadër të këtij departamenti dy njësi.

Latif Gashi mbështes rekomandimet e komisionit, megjithatë kish me qenë mirë me pas parasysh atë çfarë tha ministri paraprakisht dhe ta dëgjojmë drejtorin e departamentit buxhetit nga se ka një përvojë shumë të gjatë aty e din saktësisht qysh është më mirë.

Agim Krasniqi ky departament është departament funksional dhe për t'u ruajtur kontinuitetin, nëse mbetet ashtu siç ka qenë ky pozicion mbetet drejtor i përgjithshëm dhe të tjerët të emëruar politik dhe është procedurë që na kthen shumë mbrapa sepse në momentin që është i emëruar politik dihet çfarë funksioni kanë. E dyta që dua të them departamenti i buxhetit komunal ka një funksion për t'i ndihmu proceset buxhetore në komuna dhe për të zbatuar obligimet që dalin nga ligji për financa lokal, ai obligim është që ndarjet që bëhen nga nivelet qendrore në nivelin komunal mbi bazën e kriterëve me nga buxhetin për komunal.

Kryetarja është dashur t'i merrni në konsideratë edhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, dhe drejtori i departamentit nuk është një emërues i lartë politik por publik që shkon me të gjitha procedurat e zgjedhjes së një emëruesi të lartë publik.

Ne si komision kemi dhënë rekomandimin tonë që të zbatohet neni i ligjit dhe mos me pas ndryshim. A jeni që të mbetet varianti i plotësimit ndryshimit të ligjit, që të formohen dy departamente : Departamenti i Buxhetit dhe Departamenti i Buxhetit Komunal, kurse në ligjin e vjetër ka qenë drejtori i departamentit të buxhetit me dy njësi.

Amendamenti 6,7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, miratohen njëzëri.

Albana Fetoshi e kanë paraparë që të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë me 31 dhjetor, d.m.th është fjala për të hyra vetanake të komunave ndërsa ju këtu e keni futur apo të ndonjë organizate tjetër buxhetore. Cila është ajo organizatë tjetër buxhetore?

Agim Krasniqi përfundojnë të gjitha me 31 me përjashtim të hyrave që janë nëpër komuna dhe mos të harrojmë se kemi edhe nivelin qendror p.sh në Universitet të hyrat vetanake që i realizon mund të ndodh që nuk mundet mi shpenzu brenda afatit deri me datën 31. Vetëm ato të hyra që ligjërisht janë pjesë e buxhetit, të hyrat vetanake që ju kthehen Universitetit, Agjensionit Kosovar të Privatizimit që janë me ligj të rregullime, kjo ka të bëjë me organizata tjera.

Albani Fetoshi a ka kjo të bëjë drejtëpërdrejtë me fondin e veriut?

Kryetarja kjo nuk ka të bëjë me fondin e veriut dhe kështu ka qenë edhe më përpara.

Amendamenti i 17,18, 19, 20, 21 dhe 22, miratohen njëzëri.

5. Shqyrtimi i raportit plotësues për projektligjin nr. 04/L-163, për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Kryetarja njoftoi se lidhur me amendamentin katër ne si komision e kemi përkrah që me një vendim të qartë të Ministris që plotësim ndryshimet nga komisioni me pas të kenë mundësi që pjesa e ankesit të ndryshohet, ka kaluar në të gjitha komisionet ka kaluar në Kuvend, por Presidentja e ka kthyer. Me

kthimin që e ka bërë Presidentja ne kemi shkuar me një variant tjetër, që një vendim që vjen nga Qeveria për plotësim ndryshim të aneksit të votohet ne Kuvend. Prapë ka reaguar Komisioni për Legjislacion nuk e ka përkrahur as këtë variant. Nuk dua që të mos shkojmë në harmonizim me Komisionin për Legjislacion dhe kisha kërkuar nga anëtarët e komisionit të pajtohen, që ta fshijmë nenin katër në tërësi në dy projektligje sepse e kemi edhe Projektligjin për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike, i cili është në të njëjtat përmbajtje.

Besim Beqaj mendoj që është gabim të heqet ky nen, për shkak që e komplikon shumë më shumë situatën e veprimeve të shpejta, e veprimet e shpejta kanë pas të bëjnë vetëm me përmirësimin e ambientit për të bërë biznes, sido që të jetë konsideroj që kjo nuk reflekton mirë në asnjë infomatë për ambientin e bërjes së biznesit. Ne si Ministri e Financave jemi sipas variantit që ka shku, por Presidentja e ka bërë një veprim të tillë nuk e di këshillat ligjore dhe hapa në bazë të kujt janë marrë por me këtë jemi duke e dëmtuar ambientin për të bërë biznes në Kosovë.

Latif Gashi ne e kemi aprovuar fillimisht në komision, na është kthyer dhe në një farë mënyre u politizua u lënë anash interesi i përgjithshëm dhe shkurtimi i afateve me marrë vendime në interes të qytetarve. Meqë jemi në një situat siç jemi është mirë mos të sillemi shumë me këtë ligj, pasi që është kthyer nga Presidentja dhe Komision për Legjislacion dhe më pas nuk mund t'a fajsojmë Qeverinë sepse janë vendime që ne vet po i marrim.

Sevdije Lama nuk mendoj që është ide e mirë që ne prapë se prapë me vazhdu dhe me jap rekomandimin kundër si komision derisa e kemi edhe variantin që mundemi me dërgu në parlament bëhen votat dhe kalon nëse është në pyetje shkurtesa e afatit.

Kryetarja a pajtoheni që të shkojmë me rekomandimin e Komisionit për Buxhet që Qeveria e bjenë në rekomandim, miratohet në seancë plenare dhe bëhet i fuqishëm.

Albana Fetoshi unë mendoj që rekomandimi që ka dhënë Komisioni për Legjislacion është më i drejtë, sepse qëndroj prapa asaj që kam thënë më herët, çdo ndryshim i aneksit sado i vogël nënkupton që po ndryshohet ligji sepse aneksi është pjesë e ligjit.

Qerkin Berisha ky propozim që është dhënë prej Komisionit për Buxhet që të shkohet me vendim e ka të njejtën fuqi, nëse Kuvendi vendos në seancë ai do të vendos me 60 vota dhe e ka të njejtën fuqi të ligjit.

Kryetarja e hudh në votim variantin e Komisionit për Buxhet dhe të njejtin variant e kemi edhe tek tarifatat e veçanta të akcizës.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me një votë Kundër (Albana Fetoshi) dhe të gjithë anëtarët tjerë të pranishëm Për, nxorri këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë amendamentin për ndryshimin e nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 4

Ndryshimi dhe plotësimi i Aneksit

Aneksi 1 i këtij Ligji mund të ndryshohet dhe plotësohet, me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të grupit punues për Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryetarja grup punes i caktuar nga komisioni, dhe i ka bërë amandamentet që mendojë se janë propozime të mira.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Miratohen amendamentet e grupit punues për Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

8. Shqyrtimi i Raporti financiar vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012

Kryetarja theksoi se gjatë shqyrtimit të Raporti të Zyrës së Auditorit Gjeneral kemi vërejtur që nuk ka të dhëna për numrin e të punësuarve dhe një dallim mes tabelave ku në njëren prej tyre vlerësohej shuma 90% të shpenzimeve kurse në tjetrën 95% kurse tani shënime plotësuese i keni përpara.

Latif Gashi vlerësoj se arsye kryesore pse Komisioni ka vendosur ta kthej këtë raport kanë qenë gabimet teknike, përveq listës së pagave që e kemi kërkuar nuk shoh asgjë tjetër, por nëse është dhënë arsyetimi me shkrim duke na bindur se është vetëm gabim teknik duhet ta aprovojmë.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomadohet Kuvendit të miratoj Raportin financiar vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012.

9. Shqyrtimi Raportit financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012

Kryetarja vlerësoj se në bazë të raportit ky autoritet ka shpenzuar mjetet 82 % dhe vërejmë se ende janë të pranishme vështirësitë në ekzekutimin e mjeteve sa i përket *Shpenzimeve Kapitale* sepse ka shpenzuar vetëm 59 %. *Pagat dhe Mëditjet* 100 %, *Mallrat dhe Shërbimet* 81 % dhe *Shpenzimet Komunale* 74 %. Do të ishte mirë të organizohet një takim me Ministrinë e Administratës Publike, për të parë sesi po ec çështja e realizimit të 100% tek *Pagat dhe Mëditjet* edhe atëherë kur institucionet nuk i plotësojnë të gjithë anëtarët. Tek ART-ja nuk kemi ndonjë punëtorë të papunësuar megjithatë vërejmë disa tejkallime tek kategoria *Mallra dhe Shërbime*.

Ekrem Hoxha sqaroj se realizimi i buxhetit të vitit 2012 ka arritur nivelin e njejtë me vitet paraprake rreth 83% por për të mos e zgjatur vlerësojmë se arsyeshmëria është dhënë në Raport. Nuk është paftësia realizuese e Autoritetit por është ndërlidhshmëria e veprimeve me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik tek projektet kapitale të cilat domosdoshmërishtë duhet të jenë të projektuara nga Autoriteti. Realizimi i tyre vitin e kaluar ka qenë peng i miratimit të ligjit si dhe mospërfshirjes së një amendamenti të Autoritetit në

ligj. Këto janë arsytet pse është dashur të tërhiqen këto projekte. Mungesa e kodit në një Projekt dhe mungesa e amendamentit në ligj ka bërë që në kategorinë e Projekteve Kapitale të mos i realizoj projektet. Jemi Autoritet që nuk paguajmë Mëditje sepse nuk kemi buxhet për të paguar, dhe pagat i kemi në çdo nivel të autoritetve tjera krahasuese.

Latif Gashi konsideroj se është një raport i mirë realisht jon të përfshira planifikimet edhe shpenzimet po ashtu janë bërë krahasimet mes viteve 2011 dhe 2012, kemi një raport të përgaditur mirë, por një vërejtje do të konsideroj për të ardhmen të mos tejaklohen shpenziet siq keni bërë me kategorinë shpenzime komunale, si është rasi i rrymës.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomadohet Kuvendit të miratoj Raportin financiar vjetor të të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012.

10. Të ndryshme:

10.1. Kryetarja njoftoi se ka kontaktuar i cili është edhe i pranishëm edhe në këtë takim, me Teki Shala që të angazhohet si ekspert lokal gjatë shqyrtimit të rishikimi Buxhetit, i cili i cili do të paguhet nga buxheti i Komisionit, pasi që tashmë ka një përvojë në këtë drejtim.

Komisioni njëzëri përkrahu propozimin për angazhimin e z.Teki Shala si ekspert për shqyrtimin e rishikimit të buxhetit dhe kërkesave buxhetore dhe do të paguhet nga buxheti i Komisionit.

10.2. Njoftim për aktivitetet e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Prokurimin Publik

Latif Gashi njoftoj për takimin e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, i cili ka miratuar planin e veprimit. Aty janë paraparë të vizitohen disa institucione të pavarura, përfshirë OSHP, KRPP, ZAP, institucionet qendrore dhe lokale. Po ashtu sipas kërkesës se dy deputetëve është paraparë të organizohet edhe një dëgjim publik me operatorët ekonomik. Për këtë dëshirojmë të dijmë edhe mendimin e Komisionit, pasi që kemi pasur mendime të ndara si grup punues. Është ngritur qështja se a është në mandatin e komisionit me organizue këtë dëgjim, dhe si zgjidhje është propozuar të organizohet një dëgjim me odat ekonomike që përfaqësojnë interesat e bizneseve.

Kryetarja për monitorimin e ligjit është mirë të kenë informata nga operatorët e ndryshëm dhe në bazë të informatave t'u drejtohen me pyetje institucioneve përkatëse, në mënyrë që institucionet përkatëse të japin përgjigje nëse ka probleme në zbatueshmërinë e ligjeve. Ne mund të bëjmë dëgjim publik t'i thërrasim operatorët e ndryshëm mirëpo del jashtë punës tonë kështu që më mirë do të ishte deputetët ta ngrisin këtë çështje në Kuvendin dhe të kërkohet të formohet një komision hetimore, sepse kalojmë nga roli monitorues tek hetimi. Mendoj t'i mbetet komisionit hetimor puna e hetimeve të cilat aludohet që janë. Sponsorizues i këtij projektligjit për prokurim ka qenë Qeveria, hartuese ka qenë ministria e drejtësisë, dhe do të ishte mirë të takoheni me përfaqësues nga ministri i drejtësisë se do të mund të merrni më shumë informata, sesa me disa ministri që janë taku këto.

Albana Fetoshi arsyetja pse kemi insistuar të mbahet një dëgjim me operatorët ekonomik, që të jenë pjesë e monitorimit të ligjit dhe operatorët janë një aktër shumë i rëndësishëm për me pa qysh po zbatohet ligji, për shkak se nëse ne i përshtim vetëm disa ministri përkatëse cilin nen i ligjit po shkelet nuk

është monitorim i mirëfillt i ligjit. Nëse ne takojmë edhe operatorët ekonomik do të kemi më të qartë problemin dhe do ti parashtrojmë më mirë në Kuvend dhe do të dalin më të mira rekomandimet. Nëse është qëndrimi i komisionit që këta operatorë të heken nga monitorimi i ligjit, qëndrimi im dhe i Hykmetës është që ne të dyja do të bëjmë vetë këtë dhe të rekomandojmë të futen në raportin për monitorim të ligjit.

Latif Gashi qëllim i një monitorimi të ligji është kryesisht a duhet të me pas plotësim ndryshime dhe a ka probleme që këto institucione si rezultat i pengesave ligjore nuk mund ti realizojnë qëllimet që kanë. Ne kemi shumë operatorë dhe ka operatorë që janë shumë të kënaqur dhe depërtojnë çdo kund, mirëpo kemi operatorë që çdo herë që fajin dikujt kur nuk e merr fajin dhe nuk di çfarë opinionin marrim nga këta operatorë dhe kemi propozuar nga odat të marrin ndonjë nga përfaqësuesit e bizneseve të ndryshme.

Xhevdet Neziri sa i përket se si do të ftohen operatorët, pas takimeve në OSHP dhe KRPP, do të shohim se sa janë ankuar dhe më pas t'i përzgjedhim disa, përndryshe është e pamundur të takohemi me të gjithë operatorët.

Mbledhja përfundoi: 15:20

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj